



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

08/2023

DOBËT

Raport i monitorimit të punës së
Kuvendit të Kosovës për vitin 2022

PRILL 2023

Autor: Naim Jakaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund (RBF). Qëndrimet e shprehura në këtë raport jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e RBF.

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Prill, 2023
Prishtinë, Republika e Kosovës

LISTA E SHKURTESAVE

KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
POKP	Platforma Online e Konsultimeve Publike
RRPK	Rregullorja e Punës së Kuvendit
PL 2022	Programi Legjislativ për vitin 2022
GP LV	Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!
GP PDK	Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës
GP LDK	Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës
GP AAK	Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës
GP LS	Grupi Parlamentar i Listës Serbe
GP MULTI ETNIK	Grupi Parlamentar i deputetëve nga komunitetet jo shumicë
RRPK	Rregullorja e Punës së Kuvendit
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
GJK	Gjykata Kushtetuese
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
KiE	Këshilli i Evropës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
ME	Ministria e Ekonomisë
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	7
2. Metodologjia.....	10
3. Funksionimi pa program të punës.....	11
4. Mos efikasiteti që bartet.....	11
5. Seancat plenare.....	12
6. Mos përmbushja e rolit mbikëqyrës.....	13
7. Dështimi i Kuvendit për mbrojtjen e grave.....	13
8. Mungesa e kuorumit.....	14
9. Nismat legislative të deputetëve.....	14
10. Gjuha (Jo) parlamentare.....	14
11. Përfaqësuesit e qytetarëve me aktakuza.....	15
12. Dështimi i Kuvendit për zgjedhjen e organeve kolegjiale dhe individuale.....	16
13. Transparenca e Kuvendit.....	17
a. Mungesa e transparencës në “votimin me dorë”.....	18
14. Aktiviteti legjislativ.....	19
a. Sponsorizuesi i projektligjeve të miratuara.....	19
15. Injorimi i iniciativës së qytetarëve.....	20
16. Shmangiet në ligjbërje.....	20
17. Deklaratat jashtë rendit të ditës.....	20
18. Heshtja e komuniteteve jo shumicë.....	22
19. Llogaridhënia e Qeverisë përballë Kuvendit.....	23
a. Pyetjet parlamentare për përgjigje me gojë.....	23
b. Mos disiplinimi i qeverisë.....	25
c. Interpelancat.....	26
d. Debatet parlamentare.....	26
e. Komisionet Hetimore.....	27
20. Annex 1: Aktiviteti total i deputetëve.....	29
21. Annex 2: Kuvendi në numra.....	33

1. Përmbledhje ekzekutive

Kuvendi i Kosovës nisi punën pa miratuar Programin e Punës për vitin 2022, edhe pse një program i tillë parashihet me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Kuvendi, e nisi punën pa miratuar edhe programin e punës të sesionit vjeshtor në seancë plenare.

Viti 2022 karakterizoi Kuvendin e Kosovës me numër të madh të pikave të rendit të ditës nga seancat e mbetura nga viti 2021. Seancat e rregullta të Kuvendit janë karakterizuar me vazhdimësi të shumta të seancave, që përbëjnë 53% të totalit të seancave të rregullta.

Kontrolli parlamentar lidhur me punën e qeverisë dhe mbikqyrjes së institucioneve të pavarura pothuajse ka qenë inekzistent. Në së paku 18 raste, Kuvendi ka dështuar të miratojë raportet vjetore të institucioneve kushtetuese dhe agjencive të pavarura. Poashtu, ka dështuar në 18 raste të zgjedhë organet kolegjiale dhe individuale, duke bërë pengesë të funksionimit të tyre. Sa i përket llogaridhënies së Qeverisë përballë Kuvendit, IKD gjen se Kuvendi u injorua nga Qeveria, përderisa Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi i seancës nuk morrën masa ndaj Qeverisë, ashtu siç kërkohet me Rregullore. Edhe kjo legjislaturë, është karakterizuar nga gjuha jo parlamentare, polarizimi i skajshëm ndërmjet deputetëve dhe grupeve parlamentare dhe po ashtu ndërmjet deputetëve dhe kabinetit qeveritar. Përderisa, gjatë vitit 2022, nëntë (9%) përqind e deputetëve janë përballur me ligjin.

Transparenca dhe llogaridhënia e Kuvendit mbetet sfida. Mbledhjet e komisioneve parlamentare vazhdojnë të mos transmetohen nga Kuvendi. Ndërsa jashtë funksionit mbetet votimi elektronik në seancat plenare, duke pamundësuar informimin e qytetarëve për votat e tyre.

Në lidhje me aktivitetin legjislativ, puna e Kuvendit është përcjellë me joefikasitet. Në secilën seancë plenare, projektligjet janë bartur nga një seancë në tjetrën për shkak të mungesës së kuorumit nga ana e shumicës parlamentare dhe mos pjesëmarrjes së opozitës në procesin e votimit. Në fund të vitit 2022, Kuvendi nuk i ka shqyrtuar në parim nëntë projektligje dhe në lexim të dytë dy projektligje. Përkundër faktit që i ka shqyrtuar, Kuvendi nuk ka arritur të vendosë për tre projektligje në lexim të parë dhe për një projektligj në lexim të dytë. Këto projektligje janë bartur për shqyrtim dhe votim në sesionin pranveror të vitit 2023.

Kuvendi nuk e ka votuar asnjë projektligj të sponsorizuar nga ana e grupeve parlamentare opozitare (4 prej tyre), në ndërkohë ka votuar për dy projektligje të sponsorizuara nga grupi parlamentar i shumicës parlamentare. Kuvendi ka rritur përdorimin e praktikës së shmangies së afateve të parapara me rregulloren e Kuvendit në lidhje me shqyrtimin e projektligjeve të rëndësishme. 11% e projektligjeve janë miratuar në procedurë të përshpejtuar, ku në të shumtën e rasteve, përshpejtimi u propozua nga GP i LV-së.

Gjatë vitit 2022, janë mbajtur 2005 fjalime për 23 çështje që kanë qenë objekt i trajtimit në seanca. Kuvendi ka debatuar më së shumti në sektorët e ekonomisë dhe financave, drejtësisë, mirëqenies sociale, energjisë, shëndetësisë, sigurisë, arsimit, administratës publike, dialogut Kosovë-Serbi, punëve të jashtme dhe integriteteve evropiane.

Gjatë vitit 2022, 24 deputetë nuk kanë ngritur asnjë çështje nga totali i 2005 deklaratave. Numri më i madh i të heshturve i takon GP Lista Serbe, me gjithsej 18 deputetë.

Gjatë po këtij viti, janë parashtruar 234 pyetje parlamentare, prej të cilave 126 janë parashtruar nga opozita dhe 108 nga deputetët e shumicës parlamentare. Deputetët kanë ngritur më së shumti pyetje në sektorin e infrastrukturës, shëndetësi, ekonomi dhe financa, kulturë dhe sport, arsim, mirëqenie sociale, bujqësi, drejtësi, punë të jashtme dhe integritete evropiane si dhe për siguri.

Gjetjet e IKD-së, tregojnë se nëntë deputetë nuk ishin të pranishëm kur pyetjet parlamentare u lexuan nga Kryetari i Kuvendit, në 101 pyetje kanë munguar ministrat në seancën e parë të parashtrimit të pyetjeve. Për shkak të mungesës së ministrave në kuvend, 28 pyetje nuk kanë marrë përgjigjen e ministrave deri në seancën e fundit për vitin 2022, ndërsa 20 pyetje janë tërhequr, ngase kanë marrë përgjigje me shkrim, presin përgjigje me shkrim ose deputetët janë dorëhequr.

Nga 88 pyetjet e parashtruara, në 39 pyetje parlamentare ministra të caktuar të Qeverisë nuk ishin të pranishëm në seancën e parë plenare, kur pyetja u parashtrua nga deputeti/ja. Në asnjë prej këtyre rasteve Kryetari i Kuvendit ose Kryesuesi/ja e Kuvendit, asnjërit prej tyre nuk u'a ka tërhequr vërejtjet Kryeministrit ose ministrave të caktuar, për mungesën e tyre dhe për qasjen mospërfillëse ndaj Kuvendit dhe deputetit. Kryetari i Kuvendit njoftoi vetëm për një arsyetim që i është dërguar, në rastin e mungesës së Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetes Ariana Musliu-Shoshi.

Sa i përket instrumenteve të tjera të kontrollit parlamentar, IKD ka gjetur se janë zhvilluar tre interpelanca parlamentare, dy prej të cilave u mbajtën dhe një u shty për vitin 2023. Kuvendi mbajti edhe 15 debate parlamentare, të cilat kryesisht ishin të thirrura nga grupet parlamentare opozitare. Kuvendi nuk i votoi shumicën e mocioneve të propozuara nga grupet parlamentare opozitare, përderisa ajo votoi dy mocione të partisë që udhëheq me Kuvendin, e kjo e fundit votoi një mocion të propozuar nga grupi parlamentar i AAK-së.

Kuvendi ka dështuar që të ofroj përkthim në gjuhët zyrtare për disa nga komunitetet joshumicë gjatë punës së komisioneve parlamentare dhe në seancat parlamentare.[1]

Në lidhje me ngritjen e komisioneve hetimore, IKD gjen se pa të drejtë dhe në kundërshtim me Ligjin për Hetim Parlamentar, Kuvendi vonoi themelimin e njërit nga KHP-së për çështjen e energjisë elektrike. Në rastet kur ngritja e komisionit hetimor inicohet nga një e treta e deputetëve të Kuvendit, ky i fundit obligohet që detyrimisht ta formojë atë komision në seancë plenare. Me këtë rast, grupet parlamentare janë të obliguara të dërgojnë propozimet e tyre në mënyrë që puna e komisionit të fillojë. Kësisoj, Kuvendi nuk mundet ta shmang detyrimin kushtetues dhe ligjor për themelimin e komisionit hetimor.

[1] Koment i adresuar nga tryeza e diskutimit me temën: "Kuvendi i privilegjeve", prezantimi i raportit: "DOBËT: Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2022", e mbajtur me 28 prill 2023. Komenti është kontribut i zv. Kryetarit të grupit parlamentar MULTIETNIK, Erxhan Galushi.

2. Metodologjia

IKD në kuadër të programit Qeverisja e Mirë ka zhvilluar një monitorim holistik të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Monitorimi i Kuvendit ka për objekt administrimin e punës dhe përmbushjen e rolit Kushtetues dhe ligjor të Kuvendit. Transparenca, mbarëvajtja e seancave plenare, monitorimi i zbatimit të programit të punës, efikasiteti në miratimin e ligjeve, llogaridhënien e qeverisë para kuvendit, përmbushjen e rolit mbikëqyrës, monitorimi i nivelit të aktivitetit të deputetëve etj. janë disa nga çështjet që kanë qenë objekt më i vecantë i monitorimit.

Para së gjithash, monitorimi i IKD është bazuar në monitorimin e drejt për drejt të seancave të rregullta të Kuvendit. Po ashtu, janë përdorur edhe transkriptet dhe procesverbalet e mbledhjeve të seancave plenare dhe procesverbalet e Kryesisë së Kuvendit.

Pas monitorimit, IKD ka zhvilluar një analizë të thellë të çështjeve të ndryshme që ndërlidhen me punën e Kuvendit, të cilat janë paraqitur në këtë raport. Përmes indikatorëve specifik, janë gjeneruar të dhëna specifike, të cilat i janë nënshtruar një qasje analitike. Gjatë zhvillimit të analizës, pos të dhënave të gjeneruara nga monitorimi i drejt për drejt, IKD ka aplikuar edhe burimeve të tjera, si akte ligjore, akte nënligjore, raporte ndërkombëtare etj. Për çështje të caktuara, në një formë apo tjetrën, metodologjia e hulumtimit është e përshkruar edhe brenda raportit.

Me qëllimin që ky raport të jetë gjithëpërfshirës, para publikimit, ky raport i është dërguar Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare për komente.

3. Funksionimi pa program të punës

Kuvendi i Kosovës për herë të parë gjatë vitit 2022 është mbledhur me 15 janar 2022.[2] Puna e rregullt e Kuvendit, ka filluar ashtu siç parashihet me Rregulloren e Kuvendit (Neni 37, par. 3 i Rregullores së Kuvendit).

Kuvendi e nisi punën pa miratuar Programin e Punës për vitin 2022, përkundër faktit se një program i tillë parashihet si me Rregulloren e re[3] ashtu edhe me atë paraprake të Kuvendit[4], ku në të përfshihet agjenda legjislative e qeverisë dhe aktivitetit i deputetëve dhe i Kuvendit në përgjithësi.

Me 14 shkurt[5], Kryesia e Kuvendit autorizoj draftimin e këtij plani, të cilin e shqyrtoj me 4 prill 2022. Por, ky plan, ashtu siç kërkohet, nuk u procedua për miratim në seancë plenare dhe mbeti vetëm në nivel të Kryesisë së Kuvendit.

Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2022, Kuvendi funksioni pa një plan të debatuar dhe miratuar në Kuvend. Mungesa e një plani të tillë, përtej shkeljes së Rregullores së Kuvendit, paraqet një funksionim të pa planifikuar të punës së Kuvendit.

- **Fillimi i punës PA PROGRAM TË PUNËS**
- **Program të punës PA MIRATIM TË SEANCËS PLENARE**
- **Program të punës ME VONESË DY MUJORE – vetëm në nivel të Kryesisë së Kuvendit**
- **Fillimi i punës së sesionit vjeshtor PA PROGRAM TË PUNËS**

4. Mos efikasiteti që bartet

Kuvendi e nisi vitin 2022 me tre seanca plenare të papërfunduara nga vitit 2021, me gjithsej 38 pika të rendit të ditës.

Nga 38 pikat e papërfunduara, 29 prej tyre janë projektligje e nga këto 5, prej tyre ishin projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pikat e tjera kishin të bënin me zgjedhjen e organeve kolegjiale. Kështu, mos përfundimi i seancave dhe pikave të rendit të ditës në vitin 2021 u reflektua si ngarkesë për Kuvendin në vitin 2022.

[2] "Transkript i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 15 Janar 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_01_15_ts_Seanca_ESUX2kcfFD.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2023).

[3] "Neni 19, paragrafi 2, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës", 2022, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/2022_08_09_RregulloreKuvenditeRepublikesseKosoves_LP5sAC4XSV.pdf). (Qasur për herë të fundit me 12 janar 2023).


[4] "Neni 15, paragrafi 3, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës", 2010, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_shqip.pdf). (Qasur për herë të fundit me 12 janar 2023).

[5] "Procesverbal i Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 14 shkurt 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_027_dt_14_02_2022_MK_UxecqEj9Ny.pdf). (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2023).

Kjo situatë nuk u mënjanua as mes dy sesioneve në vitin 2022. Kjo pasi sesioni pranveror përfundoj me dy seanca të papërfunduara dhe me 15 pika të papërfunduara të rendit të ditës, të cilat mbetën për trajtim në sesionin vjeshtor.


5. Seancat plenare

Deri në fund të vitit 2022, Kuvendi i Kosovës mbi gjithsejt 56 seanca:



Treguesi nr. 1 - Numri dhe lloji i seancave të mbajura gjatë vitit 2022.

Sa i përket seancave të rregullta, IKD gjenë se të njëjtat janë karakterizuar me vazhdime të shumta në rastet kur seancat nuk kanë arritur të përfundohen brenda një ditë. IKD ka gjetur se nga 38 seancat e rregullta, 22 prej tyre janë mbajtur me vazhdime të seancave, që i bie 53% e seancave të rregullta.



Treguesi nr. 2 - Numri i seancave të rregullta, numri i vazhdimeve të atyre seancave dhe përqindja e vazhdimeve.

Në këtë drejtim, IKD gjene se deri në fund të vitit 2022 janë mbajtur gjithsej 54 vazhdime të seancave:

Numri i seancave	Numri i vazhdimeve
2	5
3	4
5	3
5	2
7	1
Total	54

Tabela nr. 1 - Numri i seancave të rregullta dhe numri i vazhdimeve.

Nga 22 seancat me vazhdimet e lartëcekura, gjashtë prej tyre nuk kanë përfunduar as gjatë vitit 2022. Ato kanë mbetur të përfundojnë në vitin 2023.

Në anën tjetër, IKD ka gjetur se Kuvendi i Kosovës nuk i ka përfunduar 54 pika të rendit të ditës, ndër to edhe 19 projektligje, për vitin 2022. Rrjedhimisht ato do të trajtohen në seancat plenare për vitin 2023.

Në raport me pikat e bartuara për vitin 2023, vlenë të theksohet se ka pika, trajtimi i të cilave ka tejkaluar çdo afat procedural, siç është Propozim-rezoluta në lidhje me mosrealizimin e projekteve kapitale të Qeverisë gjatë vitit 2022 dhe trajtimi i Propozim-Rezolutës për gjendjen në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

6. Mos përmbushja e rolit mbikëqyrës

Sipas Kushtetutës [neni 65.9] Kuvendi “mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendi”. Në lidhje me këtë, IKD ka gjetur se Kuvendi gjatë vitit 2022 dështoj që të ushtrojë këtë rol kushtetues.

Kuvendi nuk ka arritur të diskutojë dhe të votojë për 18 raporte dhe kërkesa të institucioneve kushtetuese dhe agjencive të pavarura. Në mesin e këtyre raporteve janë: raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit, Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për, Raportit vjetor i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës etj.

7. Dështimi i Kuvendit për mbrojtjen e grave

Më 15 shtator 2022 Kuvendi nuk arriti që të shqyrtojë dhe votojë raportin me rekomandime lidhur me zbatimin e Ligjit nr.05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, për shkak të mungesës së kuorumit.

Komisioni për Legjislacion, si komision monitorues kishte konstatuar se Ligji është i pazbatueshëm në praktikë dhe moszbatimi i tij nuk ndërlidhet me nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, por për shkak të mosveprimit të institucioneve përgjegjëse, në këtë rast Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Gjetjet nga ky raport përfshinin mos ndarje të buxhetit në mënyrë që ky ligj të fillojë të zbatohet. Po ashtu, raporti gjente mungesë të trajnimeve për gjyqtarë për këtë çështje nga Akademia e Drejtësisë, mungesë të kërkesave ndaj Shërbimit Sprovues për hartimin e raportit para-ndëshkues në zbatim të mbikëqyrjes elektronike dhe mungesë të informacioneve nëse është shqiptuar një masë e tillë për mbikëqyrje elektronike. Për më tepër, ende nuk është përfunduar asnjë studim i fizibilitetit për të parë mundësinë e zbatimit të kësaj mase nga ana e këtij institucioni.

KGJK kishte njoftuar se nuk ka vendime gjyqësore që lidhen me këtë ligj, asnjë kërkesë nuk është ushtruar ndaj gjykatave nga prokurorët dhe avokatët për vendosje për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike.

8. Mungesa e kuorumit

Kuvendi ka arritur të organizojë punën e vet sipas praktikës së mëhershme, duke mbajtur seancë plenare të rregullt, të paktën, çdo të enjte.

Puna e Kuvendit të Kosovës është karakterizuar me bartjen e shumë pikave të rëndësishme nga një seancë në tjetrën, si pasojë e mungesës së kuorumit, duke bërë që ato të gumbullohen e të zvarriten me muaj të tërë. Tabela nr. 1 tregon se në më shumë se gjysmën e seancave të rregullta ka pasur vazhdime, në disa seanca me pesë vazhdime e në disa me katër vazhdime. Fillimisht, mos funksionimi i rregullt i Kuvendit për shkak të mungesës së deputetëve paraqet shkelje të rolit kushtetues që ka deputeti. Sipas Kushtetutës [neni 74] “Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë...”.

Përtej kësaj, kuptohet se asnjë Qeveri nuk mund të realizojë planin e saj në mënyrë adekuate nëse nuk ka funksionim të rregullt të Kuvendit. Legjislatura aktuale, për dallim nga të gjitha të tjerat, karakterizohet me numrin e madh të deputetëve të partisë e cila kryeson me Qeverinë. Për këtë arsye, mungesa e funksionimit normal të Kuvendit i atribuohet edhe Qeverisë, e cila nuk arrinë që të mbledhë shumicën e saj që ka në Kuvend.

9. Nismat legjislative të deputetëve

Gjatë vitit 2022 është vërejtur aktivitet i shtuar i deputetëve dhe grupeve parlamentare për të propozuar nisma legjislative. Në këtë drejtim, nismat kryesisht kanë qenë iniciativa të grupeve parlamentare opozitare.

Gjatë vitit 2022, deputetët iniciuan 10 projektligje. Krahasuar me vitet paraprake dhe legjislaturat paraprake, i bie se në vitin 2022 ka pasur një ngritje të aktivitetit të deputetëve në kuptim të nismave legjislative.

Në legjislaturën e III-të dhe IV-të, kishte vetëm një projektligj të propozuar nga ana e deputetëve, në legjislaturën e VI-të totali i nismave legjislative nga ana e deputetëve ishte në 13 projektligje, në legjislaturën e VII-të 12 projektligje në total. Ndërsa, numri i nismave legjislative vetëm gjatë vitit 2022 ka qenë 10, që paraqet një rritje të aktivitetit të deputetëve sa i përket nismave legjislative.

10. Gjuha (Jo) parlamentare

“A rob’t jua q***.”, “Mos u mundoni t’i bëni argat Vuçiqit”, “Që ka paaftësi në të menduar kjo është e dukshme.” “pasi u mbyll mikrofoni në stilin e një banditi”, “Po më vjen keq për frustrimin tënd...”, “Mbylle gojën, mbylle gojën se unë po flas, tani dil ti, e unë të thashë tash mbylle gojën, mjaft më!”, “Para një muaji ishte strukur këtu si pulë...”, “Është si me lyp prej qorrit sy...”, “Turpi i diplomacisë kosovare.”, “Unë nuk muj me folë serbisht se s’di. Po vazhdoj shqip.” “Foli në serbisht, por ndoshta edhe e ka mendu n’serbisht.” “Foli palidhje, nuk tha kurgjo.”

Me ardhë sot me i ndëgjua këta e me u bë na spektatorë dhe fjalimeve të kalamajve që kanë dal prej çerdhes e kanë ardhë këtu me na shit qallëm, “Kryeministër, të lutem lidhe zëvendëskryeministrin!”, “Trego çka po bëhet me Rakiqin tënd, njëjtë si ai tjetri është, ti je me të në tavolinë tash.”, kanë qenë disa nga fjalitë që deputetët dhe kabineti qeveritar i ka shkëmbyer ndërmjet veti gjatë zhvillimit të seancave plenare dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës.

Gjuha e tillë e përdorur nga ana e deputetëve dhe nga ana e kabinetit qeveritar është kritikuar edhe nga organizata e individë që në mënyrë direkte ose indirekte janë prekur nga ana e këtyre fyerjeve. Shoqata e të Verbërve ka reaguar ndaj ndaj gjuhës ofenduese të deputetit të Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha. Ky i fundit kishte përdorur fjalinë: “Është si me lyp prej qorrit sy”, e cila kishte nxitur reagimin e shoqatës. Për këtë shoqatë, është shqetësuese dhe e dhimbshme kur një gjuhë e tillë përdoret nga ana e përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve.[6] Në lidhje më fjalën e përdorur nga ana e deputetit Dimal Basha, ky i fundit kishte kërkuar falje për gjuhën e përdorur.[7]

Gjuha e tillë e përdorur në Kuvendin e Kosovës, polarizimi i skajshëm ndërmjet deputetëve dhe grupeve parlamentare dhe po ashtu ndërmjet deputëve dhe kabinetit qeveritar, ishte kritikuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022. Në këtë raport thuhet se gjatë vitit 2022, puna e Kuvendit të Kosovës është përcjellë nga një atmosferë e polarizuar politike,[8] gjë që kishte ndikuar në rolin e dobët të Kuvendit si një vend i përfaqësuesve që ata të jenë shembull për dialog politik konstruktiv dhe për ndërtimin e konsensusit veçanërisht për tema jetike për vendin.

Kuvendi i Kosovës, në korrik të vitit të kaluar ka miratuar Rregulloren e re të Punës, ku në Nenin 129 të saj parashihet miratimi i Kodit të Sjelljes së deputetit, por një kod i tillë ende nuk është miratuar.

Në këtë aspekt, Kuvendi sa më parë duhet të nisë procedurat për dratimin dhe diskutimin me palët e interesit të një kodi të sjelljes për deputetë. Ky kod do të duhej që mjaftueshëm të përshkruajë natyrën e përgjithshme dhe të veçantë të sjelljeve jo parlamentare të deputetëve. Miratimi i një kodi të tillë do të shprehte vlerat e përbashkëta dhe parimet kryesore të cilat do ta orientonin dhe vlerësonin sjelljen e deputetëve.

11. Përfaqësuesit e qytetarëve me aktakuza

IKD, ka identifikuar njëmbëdhjetë deputetë që gjatë vitit 2023 janë përballur me ligjin. Në këtë numër kanë prirë deputetët e LV-së, pastaj AAK-së, më tutje PDK-së dhe grupit parlamentar MULTIETNIK.

[6] “Si me lyp prej qorrit sy”, Shoqata e të Verbërve reagon ndaj gjuhës ofenduese të deputet Bashës, 2022, Ekonomia Online. (Shih linkun <https://ekonomiaonline.com/si-me-lyp-prej-qorrit-sy-shoqata-e-te-verbërve-reagon-ndaj-gjuhes-ofenduese-te-deputet-bashes/>). (Qasur për herë të fundit me 5 prill 2023).

[7] “Dimal Basha kërkon falje për deklaratën “si me lypë prej qorrit sy”, 2022, Gazeta Blic. (Shih linkun <https://gazetablic.com/dimal-basha-kerkon-falje-per-deklaraten-si-me-lype-prej-qorrit-sy/>). (Qasur për herë të fundit me 5 prill 2023).

[8] Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022, fq. 8”, 2022, Komisioni Evropian. (Shih linkun <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 5 prill 2023).

- 7 deputetë të LV-së me aktakuza aktive gjatë vitit 2022. Glauk Konjufca, Mimoza Kusari-Lila[9], Artan Abrashi, Valon Ramadani, Jetmire Vrenezi, Salih Zyba dhe Fitore Pacolli-Dalipi).
- 2 deputetë të AAK-së me aktakuza aktive gjatë vitit 2022. (Pal Lekaj dhe Time Kadrijaj).
- 1 deputet i PDK-së me aktakuzë aktive gjatë vitit 2022. (Xhavit Haliti).
- 1 deputet nga GP MULTIETNIK me dënim të formës së prerë (Samra Ilijaz), 11 deputetë të Kuvendit persona që kanë probleme me ligjin, 9.2% e Kuvendit të Kosovës.

Veprat penale për të cilat janë akuzuar deputetët gjatë vitit 2022:

- “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”
- “Sulmi”
- “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”
- “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”
- “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

12. Dështimi i Kuvendit për zgjedhjen e organeve kolegjiale dhe individuale

Njëra ndër rolet e rëndësishme të Kuvendit është roli zgjedhës i tij. Sipas këtij roli, në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, propozon dhe zgjedhë zyrtarë të ndryshëm në institucione të caktuara, funksionimi i të cilave varet pikërisht nga zgjedhja e këtyre zyrtarëve nga Kuvendi.

Përballë këtij roli, IKD gjenë se Kuvendi nuk ka arritur që të zgjedhë një numër të konsiderueshëm të këtyre zyrtarëve. Kështu, në shumë raste, ka qenë pikërisht mosveprimi i Kuvendit arsyeja e mos funksionimit, të paktën funksionimit jo të plotë, të këtyre institucioneve.

Në lidhje me këtë, IKD gjënë se gjatë vitit 2022, Kuvendi nuk arriti të përmbushë obligimet e saja në raport me përzgjedhjen e zyrtarëve në këto institucione:

- 1) Gjykata Kushtetuese me një gjyqtar;
- 2) Komisioni i Pavarur i Mediave me tre anëtarë;
- 3) Komisioni i Pavarur i Konkurrencës me 2 anëtarë;
- 4) Bordi i Ankesave i Mediave me një anëtar;
- 5) Avokati i Popullit me në zëvendës Avokat të Popullit;
- 6) Këshilli Gjyqësor i Kosovës me 2 anëtarë;

[9] Shënim: Mimoza Kusari Lila ishte liruar nga akuzat në nëntor 2022, vendim ky i cili më pas ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 29 mars 2023. “Afera e Hidrocentraleve”, Apeli vërteton aktgjykimin lirues ndaj katër ish-ministrave të Qeverisë Thaçi 2 dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 29 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/afere-e-hidrocentraleve-apeli-verteton-aktgjykimin-lirues-ndaj-kater-ish-ministrave-te-qeverise-thaci-2-dhe-dy-te-tjereve/>). Qasur për here të fundit më 24 prill 2023.

- 7) Organin Shqyrtues i Prokurimit me një anëtar;
- 8) Këshillit i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me dy anëtarë nga komunitetet joshqiptare;
- 9) Agjencia Kosovare e Pronës - Bordi Mbikëqyrës, me dy anëtarë,
- 10) Agjencia Kosovare e Pronës - Komisioni për Kërkesa Pronësore, me një anëtar;
- 11) Agjencia Kosovare e Pronës - Sekretariati Ekzekutiv, Drejtori dhe Zëvendës-drejtori;
- 12) Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me një anëtar – Kryesues;
- 13) Zyra e Rregullatorit për Energji me dy anëtarë;
- 14) Agjencia Kosovare e Privatizimit me një anëtar- Kryesues;
- 15) Bordi i Autoritetit Rregullativ i Hekurudhave me katër anëtarë;
- 16) Bordi i Fondit i Kursimeve Pensionale;
- 17) Guvernatori i BQK;
- 18) Komisioni për Ndihmë Shtetërore në procedurë me katër anëtarë.

Me vonesa të konsiderueshme, Kuvendi emëroi Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës.[10] Që nga muaji qershor i vitit 2021 kur ka përfunduar mandati i kryetarit dhe komisionit të kaluar, ky institucion nuk e ka pasur këtë trupë funksionale. Qeveria propozoi emërimin e pesë anëtarëve të këtij komisioni, por për shkak të mos pjesëmarrjes në votim dhe mungesës së kuorumit, votimi për këtë komision u bë me një muaj e gjysmë vonesë, me 14 qershor 2022.[11]

Me shumë vonesa u përshkua edhe procesi për emërimin e dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, ku ky proces dështoi dy herë radhazi – si mungesë e votave të mjaftueshme në procesin e votimit në dhjetor të vitit 2021 dhe maj të vitit 2022. Një gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese u propozua nga Kuvendi vetëm më 24 nëntor 2022.

13. Transparenca e Kuvendit

Gjatë viteve të fundit Kuvendi ka ndërmarrë disa hapa pozitiv në raport me transparencën. Për publikun janë të qasshme dokumentet themelore të mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe seancave parlamentare. Janë të qasshme procesverbalet e Kryesisë së Kuvendit dhe informacionet e tjera bazike të Kryetarit, Nënkryetarëve, Kryetarëve të grupeve parlamentare, deputetëve dhe Kryetarëve të komisioneve parlamentare.[12]

Përkundër progresit, monitorimi i IKD gjen se Kuvendi në fusha të caktuara vazhdon të pëballet me mungesë transparence. Kuvendi nuk ka bërë hapa të duhur në raport me publikimin e të gjitha materialeve me rastin e ftesës së një seance parlamentare. Ftesa dhe rendi i ditës publikohen, por nuk janë të qasshme materialet në lidhje me mbledhjen e caktuar. Në të gjitha rastet, nuk publikohen mocionet përmbajtësore të grupeve parlamentare, nuk janë të publikuara rekomandimet e komisioneve për projektligje dhe për zgjedhjen e organeve individuale dhe kolegjiale, në rastin e fundit.

[10] Qeveria e Kosovës me 9 mars 2022 i propozoi Kuvendit të Kosovës përbërjen e re të këtij komisioni. Për më shumë në linkun vijues, Vendimi nr Nr. 07/67, Datë: 09.03.2022 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/03/Vendimet-e-mbledhjes-se-67-te-te-Qeverise.pdf>

[11] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 5, 11, 13 maj dhe 6, 14 qershor 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_05_05_ts_Seanca_5Bnr89WmEY.pdf). Qasur për herë të fundit me 10 janar 2023).

[12] Informacionet për Kryetarin e Kuvendit: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/kryetari-i-kuvendit/>; Linku i takimeve të Kryesisë:

<https://www.kuvendikosoves.org/shq/kryesia/takimet-e-kryesise/>; Linku i komisioneve parlamentare:

<https://www.kuvendikosoves.org/shq/komisionet/>; Linku i dokumentacionit të seancave plenare:

<https://www.kuvendikosoves.org/shq/seancat/seancat/>.

Në anën tjetër, komisionet parlamentare mbajnë mbledhje të hapura, por këto mbledhje vazhdojnë të mos transmetohen direkt në faqen zyrtare të Kuvendit, përmes Radio Televizionit Publik ose përmes një agjencie private të lajmeve siç bëhej tre vite më parë. Rrjedhimisht, përkundër faktit se këto mbledhje janë të hapura për mediat, publiku i gjerë nuk ka qasje në këto takime, në rastet kur të njëjtat nuk mbulohen nga mediat. Në drejtim të ngritjes së transparencës, IKD i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të angazhohet që takimet e këtyre komisioneve të jenë publike edhe në faqen e saj zyrtare, ashtu siç tanimë kanë vepruar disa institucione.

Kuvendi ka miratuar Planin e Veprimit për Kuvend të Hapur 2023-2026, në të cilin janë listuar të gjitha veprimet që Kuvendi të përmirësojë qasjen në informacion, të lehtësojë pjesëmarrjen e qytetarëve, mediave dhe OShC-ve në punën e Kuvendit, në rritjen e llogaridhënies, digjitalizimi dhe avancimin e teknologjisë informative.

Si institucioni më i lartë ligjvënës në Kosovë, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e popullit, Kuvendi duhet të kujdeset për zbatimin e standardeve më të lartë të transparencës.

a. Mungesa e transparencës në “votimin me dorë”

Tre vitet e fundit, Kuvendi vazhdon të zhvillojë punën në seanca parlamentare duke votuar “me dorë” për arsye se votimi elektronik është jashtë funksionit. Si pasojë, qytetarët, shoqëria civile ose kushdo tjetër që është i interesuar, nuk mund ta dijë se për një çështje të caktuar si ka votuar një deputet.

Kuvendi ka miratuar Rregulloren e re të Kuvendit me 28 korrik 2022, e cila në raport me transparencën në lidhje me publikimin e votës së deputëve kërkon që ai të bëhet publik menjëherë pas përfundimit të seancës plenare. Më tutje, sipas kësaj rregulloreje, nëse votimi bëhet me dorë, atëherë publikimi i votimit me dorë bëhet publike brenda dy (2) ditë pune pas përfundimit të votimit në seancë plenare.[13]

Përkundër kësaj, IKD gjenë se ky obligim është i pazbatueshëm në praktikë. Si rrjedhojë, përkundër miratimit të rregullores së re, qytetarët ende nuk mund ta dinë se si kanë votuar përfaqësuesit e tyre.

IKD i bënë thirrje Kuvendit që të angazhohet maksimalisht në funksionalizimin e sistemit elektronik të votimit. Përtej efikasitetit, ky sistem ngrit edhe transparencën. Deri në funksionalizimin e këtij sistemi, IKD i rekomandon Kuvendit që në përputhje me rregulloren e re, Kuvendi të publikojë në secilin rast rezultatet e “votimeve me dorë”.

[13] “Neni 61, paragrafi 9, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës”, 2022, Gazeta Zyrtare e Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkg1E5EcTI3ZFBSCGcbPz0Vh5lt7ysr9nvzgMndq-6nYhvjiJBQF00qKQ>). (Qasur për herë të fundit me 12 janar 2023).

14. Aktiviteti legjislativ

Aktiviteti legjislativ është përcjellë nga mos efikasiteti i Kuvendit në miratimin projektligjeve dhe pikave të tjera të rendit të ditës, sipas rendit të ditës për të cilin Kryesia e Kuvendit kishte vendosur në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare.

Gjatë vitit 2022, Kuvendi shqyrtoi 117 projektligje.

- 117 projektligje të shqyrtuara
- 111 projektligje të miratuara
- 6 projektligje të refuzuara nga Kuvendi
- Rregullorja e re të Kuvendit të Kosovës – E MIRATUAR.

Kuvendi nuk ka arritur të shqyrtojë në parim nëntë projektligje dhe në lexim të dytë dy projektligje. Përkundër faktit që i ka shqyrtuar, Kuvendi nuk ka arritur të vendosë për tre projektligje në lexim të parë dhe për një projektligj në lexim të dytë. Këto projektligje janë bartur për shqyrtim dhe votim në sesionin pranveror në vitin 2023.

Nga totali i 117 projektligjeve të shqyrtuara, del se 49 projektligje janë ndryshim-plotësime, 41 projektligje janë të reja dhe 27 projektligje janë marrëveshje ndërkombëtare.

Sa i përket propozuesve të projektligjeve, numrin më të madh të projektligjeve e ka proceduar Qeveria e Kosovës.

Në anën tjetër, është për tu vlerësuar pozitivisht fakti se gjatë vitit 2022, Kuvendi miratoi rregulloren e re të punës.

a. Sponsorizuesi i projektligjeve të miratuara

- 108 projektligje nga Qeveria e Kosovës
- 2 projektligje nga grupet parlamentare
- 1 projektligj nga Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes
- 70 projektligje të procedura në vitin 2021, të shqyrtuara dhe miratuara nga Kuvendi në vitin 2022
- 41 projektligje të procedura në vitin 2022, të shqyrtuara dhe miratuara nga Kuvendi në vitin 2022

2 projektligje nga Komisionet parlamentare

- 1 projektligj i proceduar në vitin 2022, i shqyrtuar dhe miratuar në vitin 2022
- 1 Rregullore e proceduar në vitin 2021, e shqyrtuar dhe miratuar në vitin 2022

Sponsorizuesi i projektligjeve të refuzuara nga ana e Kuvendit të Kosovës

- 4 projektligje të propozuara nga grupet parlamentare
- 2 projektligje të propozuara nga Qeveria

15. Injorimi i iniciativës së qytetarëve

Kuvendi i Kosovës e injoroi shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. 08/L-062 për faljen e masave ndëshkimore të vendosura gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, nismë legislative prej më shumë se 10.000 qytetarë të Kosovës.

Projektligji në fjalë i'u është shpërndarë deputetëve me 28.10.2021 dhe është shqyrtuar në parim në komisionin funksional me 05.10.2022, përderisa është radhitë për shqyrtim edhe në seancë plenare me 27.10.2022. Përkundër se Projektligji në fjalë u pranua në vitin 2021, Kuvendi nuk ka arritur që për këtë pikë të rendit të ditës të votoj as në vitin 2022.

16. Shmangiet në ligjbërje

Nga monitorimi rezulton se gjatë vitit 2022, IKD gjenë se janë propozuar 17 mocione procedurale për shmangie nga afatet e rregullta për shqyrtimin e projektligjeve, 13 prej të cilave u aprovuan. Propozime kanë ardhur nga grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (15) dhe Komisioni Funksional për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes (2).

Kështu, Kuvendi ka vazhduar me praktikën e shmangies së afateve të parapara me rregulloren e Kuvendit në lidhje me shqyrtimin e projektligjeve të rëndësishme. Nga totali i projektligjeve të miratuara, del se 11.11% e tyre janë miratuar në procedurë të përshpejtuar. Një gjë e tillë është parë si proces i dëmshmëm edhe nga Raporti i Progresit për vitin 2022 i Komisionit Evropian, i cili ka theksuar se Kuvendi gjatë vitit 2022 rriti përdorimin e procedurave të përshpejtuara të miratimit të legjislacionit me interes të rëndësishëm.[14]

IKD i rekomandon Kuvendit që praktika e shmangieve procedurale mos të jetë kaq e shprehur. Në parim, procesi legjislativ duhet të jetë i rregullt, në mënyrë që të garantohet gjithëpërfshirje adekuate dhe transparencë, dhe shmangiet duhet të praktikohen vetëm kur nga natyra e çështjes dhe urgjenca në trajtimin e saj e kërkojnë këtë. Aplikimi i këtij instituti pa iu përmbajtur këtyre kriterëve paraqet humbje të kuptimit të këtij instituti dhe praktikë të dëmshme në procesin e ligjbërjes.

17. Deklaratat jashtë rendit të ditës

Për shkak të rëndësisë që ka, njëra ndër pikat më të rëndësishme dhe standard në çdo seancë të rregullt, është ajo e deklarimeve jashtë rendit të ditës. Është fillimi i çdo seance dhe në këtë mënyrë qytetarët mund të bëhen pjesë dhe të dëgjojnë e të shohin se për çka deklarohen përfaqësuesit e zgjedhur për çështjet që nuk janë në rend të ditës.

[14] "Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022, fq. 8", 2022, Komisioni Evropian. (Shih linkun <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 5 prill 2023).

Sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës, deputeti, në emër të grupit parlamentar ose në emër të tij, pasi të ketë njoftuar Kryetarin e Kuvendit, ai mund të diskutojë çështje të ndryshme që i konsideron se duhet të bëhen publike në mbledhje plenare. Deklarimi në emër të grupit parlamentar bëhet deri në pesë minuta ndërsa në emër të tij, ai nuk mund të flasë më shumë se tre (3) minuta. Koha maksimale për këtë pikë është 30 minuta (me rregulloren e vjetër, të shfuqizuar), ndërsa me rregulloren e re, 40 minuta.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ka monitoruar këtë pikë të rëndësishme dhe në bazë të këtij monitorimi ka gjetur se 270 deklarata jashtë rendit të ditës u parashtruan nga deputetët e gjashtë grupeve parlamentare për 23 tema të caktuara.

192 Deklaratat nga opozita

78 Deklaratat nga opozita

Treguesi nr. 3 - Numri i deklaratave pozitë/opozitë.

Temat që kanë përmendur deputetët te pika e deklarimeve jashtë rendit të ditës janë:

Numri i deklaratave	Tema/Çështja	Numri i deklaratave	Tema/Çështja
39	Mirëqenie Sociale	6	Çështje komunale
32	Drejtësi	5	Efikasitet në Qeverisje
31	Punë të Jashtme dhe Integritet Evropian	5	Kulturë dhe Sport
26	Ekonomi dhe Financa	4	Diasporë
25	Siguri	4	Histori
19	Shëndetësi	1	Mjedis
19	Arsim	1	Liria e Medias
17	Dialogu Kosovë-Serbi	1	Zgjedhja e organeve kolegjiale
11	Bujqësi	1	Dhuna online ndaj grave
9	Infrastrukturë	1	Lëvizja e lirë të njerëzve
6	Të drejtat e komuniteteve	1	Për procedurë
6	Administratë Publike		

Tabela nr. 2 - Tema dhe numri i deklaratave jashtë rendit të ditës.

Grupi me më së shumti deklarata jashtë rendit të ditës është ai i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i pasuar nga ai i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (LV), më tutje nga ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), grupit parlamentar MULTIETNIK dhe grupi parlamentar të Listës Serbe (LS) me vetëm një deklaram.



Treguesi nr. 4 Numri i deklaratave pozitive/opozitive.



Treguesi nr. 5 - Numri i deklaratave pozitive/opozitive në bazë të përqindjes.

18. Heshtja e komuniteteve jo shumicë

IKD gjen se nga 38 seancat e rregullta, Lista Serbe është deklaruar vetëm njëherë tek pika Deklaratat jashtë rendit të ditës, përkundër faktit që asaj i është dhënë e drejta në çdo seancë. Sipas kësaj, rezulton se Lista Serbe ka pasur mundësi të marrë fjalën më së paku 38 herë dhe këtë të drejtë e ka realizuar vetëm një herë, përderisa edhe grupi parlamentar MULTIETNIK, nuk ka marrë fjalën më shumë se shtatë (7) herë.

Me qëllim të afirmimit të interesave të komuniteteve jo shumicë në Kosovë, Kushtetuta dhe ligji kanë paraparë kompetenca të zgjeruara për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Por, IKD gjenë se çështjet e rëndësisë jetike për komunitetet jo shumicë, nuk u adresuan nga përfaqësuesit e tyre në Kuvend. Vecanerisht, kjo u pa në rasisht të Listës Serbe. Mos adresimi i çështjeve ekonomike, sociale, shëndetësore etj. të komuniteteve jo shumicë, krahas të tjerave, e humb kuptimin e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në Kuvend. Është jo reale të mendohet se komunitetet jo shumicë në Kosovë nuk përballen me asnjë problem social, ekonomik etj.

Në nëntor të vitit të kaluar, dhjetë deputetët e Grupit Parlamentar të Listës Serbe, i dorëzuan dorëheqjet e tyre në Kuvendin e Kosovës^[15] për shkak arsyesimit, siç kanë thënë ata që Qeveria e Kosovës të tërheq vendimet e njëanshme dhe të kundërligjshme për reregjistrim, derisa me 17 nëntor 2022 u betuan 10 deputetë të tjerë nga Lista Serbe.^[16]

[15] "Deputetët e Listës Serbe i dorëzojnë dorëheqjet e tyre zyrtarisht në Kuvendin e Kosovës". Betimi për Drejtësi, 7 nëntor 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputetet-e-listes-serbe-i-dorezojne-doreheqjet-e-tyre-zyrtarisht-ne-kuvendin-e-kosoves/>). Qasur për herë të fundit me 10 janar 2023).

[16] "Lista Serbe: I morëm mandatet në Kuvend për t'i ruajtur". Evropa e lirë, 17 nëntor 2022. (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/deputetet-serb-betohen-ne-kuvend/32134901.html>). Qasur për herë të fundit me 10 janar 2023).

19. Llogaridhënia e Qeverisë përballë Kuvendit

Kushtetuta, Ligji dhe Rregullorja e Kuvendit i kanë dhënë Kuvendit mjete të ndryshme për të mbajtur llogaridhënës Qeverinë, e cila duhet ti përgjigjet Kuvendit. Përkundër kësaj, IKD gjenë se gjatë vitit 2022, këto mjete nuk ishin efektive. Në disa raste, siç ishin pyetjet parlamentare, Kuvendi u injorua nga qeveria, dhe Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi i seancës nuk morrën masa ndaj Qeverisë, ashtu siç kërkohet me Rregulloren. Në raste të tjera, IKD gjenë se vet mënyra e aplikimit të mjeteve të kontrollit, sic janë komisionet hetimore parlamentare, pa arsyeshëm u bë temë diskutimi në Kuvend, përkundër se dispozitat ligjore ishin të qartë.

a. Pyetjet parlamentare për përgjigje me gojë

IKD ka gjetur se deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë shfrytëzuar 234 herë^[17] të drejtën e parashtrimit të pyetjeve parlamentare ndaj kabinetit të qeverisë. Këto pyetje, në sesionin pranveror janë parashtruar në pajtim me Rregulloren e vjetër të Kuvendit^[18], ndërsa në sesionin vjeshtor ato janë parashtruar në pajtim me Rregulloren e re të Kuvendit.^[19] Sipas rregullores së re, koha e ndarë për pyetjet parlamentare është 60 minuta për seancë dhe deputeti për një seancë plenare mund të parashtrojë më së shumti dy pyetje.

Në total, 53.8% e pyetjeve u parashtruan nga grupet parlamentare opozitare, derisa 46.2% të pyetjeve u parashtruan nga dy grupet parlamentare që përbëjnë shumicën parlamentare. Grupi Parlamentar i Listës Serbe nuk parashtroi asnjë pyetje parlamentare.

234 Pyetje të parashtruara

126

Pyetje parlamentare nga opozita

108

Pyetje parlamentare nga pozita

Treguesi nr. 6 Numri total i pyetjeve parlamentare dhe dallimi pozitë/opozitë.

[17] *Shënim i rëndësishëm*: Monitorimi i pyetjeve parlamentare është bërë duke u bazuar në transkriptet e publikuara në faqen e Kuvendit. Gjatë monitorimit është vërejtur që Kryetari i Kuvendit dhe në raste të caktuara edhe kryesuesit e seancave, nuk e precizojnë saktë dhe qartë, emrin dhe mbiemrin e deputetit si dhe kujt i është drejtuar pyetja parlamentare. Ky veprim për monitoruesit e IKD-së, ka paraqitur vështirësi në identifikimin dhe përcjelljen e pyetjes në rastet kur ka munguar Ministri/ja i/e caktuar në seancë plenare.

[18] *"Neni 45, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës"*, 2010, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_shqip.pdf). (Qasur për herë të fundit me 12 prill 2023).

[19] *"Neni 92, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës"*, 2022, Kuvendi i Kosovës. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/2022_08_09_RregulloreKuvenditeRepublikesseKosoves_LP5sAC4XSV.pdf). (Qasur për herë të fundit me 12 prill 2023).

Temat që deputetët kanë ngritur përmes pyetjeve parlamentare[20] janë:

Numri i pyetjeve	Tema/Çështja	Numri i pyetjeve	Tema/Çështja
37	Infrastrukturë	10	Punë të Jashtme dhe Integritet Evropian
36	Shëndetësi	9	Siguri
27	Ekonomi dhe Financa	6	Administratë Publike
23	Kulturë dhe Sport	3	Dialogu Kosovë-Serbi
20	Arsim	3	Të drejtat e komuniteteve
15	Mirëqenie Sociale	3	Diasporë
13	Bujqësi	2	Çështje komunale
11	Drejtësi	1	Mjedis

Tabela nr. 3 - Tema dhe numri i pyetjeve parlamentare.



Treguesi nr. 7 Numri i pyetjeve parlamentare në bazë të grupeve parlamentare.



Treguesi nr. 8 - Numri i pyetjeve parlamentare në bazë të përqindjes.

Nga 234 pyetjet parlamentare, nëntë deputetë nuk ishin të pranishëm kur pyetjet parlamentare u lexuan nga Kryetari i Kuvendit.

Nga 234 pyetjet parlamentare, në 101 pyetje kanë munguar ministrat në seancën e parë të parashtrimt të këtyre pyetjeve, ndërsa në 133 pyetje parlamentare, kabineti qeveritar ka qenë i pranishëm në seancën e parë kur është parashtruar pyetja parlamentare.

Nga 234 pyetjet parlamentare, për shkak të mungesës së ministrave në Kuvend, 28 pyetje nuk kanë marrë përgjigjen e ministrave deri në seancën e fundit për vitin 2022. 11 prej këtyre pyetjeve i ishin adresuar vetëm Ministrit të Shëndetësisë.

[20] Shënim: Pesëmbëdhjetë (15) pyetje parlamentare nuk u dihet tema për çka kanë pasur të parashtrihen për arsye se në këto raste ministrat nuk kanë qenë të pranishëm, rrjedhimisht pyetja nuk është lexuar nga deputeti dhe në transkriptin dhe në procesverbalin e seancës plenare nuk figuron çështja.

Nga 234 pyetjet parlamentare, nëntë deputetë nuk ishin të pranishëm kur pyetjet parlamentare u lexuan nga Kryetari i Kuvendit.

Nga 234 pyetjet parlamentare, në 101 pyetje kanë munguar ministrat në seancën e parë të parashtrimit të këtyre pyetjeve, ndërsa në 133 pyetje parlamentare, kabineti qeveritar ka qenë i pranishëm në seancën e parë kur është parashtruar pyetja parlamentare.

Nga 234 pyetjet parlamentare, për shkak të mungesës së ministrave në Kuvend, 28 pyetje nuk kanë marrë përgjigjen e ministrave deri në seancën e fundit për vitin 2022. 11 prej këtyre pyetjeve i ishin adresuar vetëm Ministrit të Shëndetësisë.

Në mungesë të ministrave në seancë parlamentare, deputetët e Kuvendit kanë tërhequr nga 20 pyetje parlamentare, ngase kanë marrë përgjigje me shkrim ose presin përgjigje me shkrim[21].

Përgjithësisht, IKD gjenë një jo efikasitet të pyetjeve parlamentare, si një prej mjeteve të Kuvendit për të mbajtur llogaridhënësë Qeverinë. Kryesisht, mungesa e efikasitetit ka ardhur si rezultat i injorimit që Qeveria gjatë vitit 2022 i bëri Kuvendit. Në këtë rast, duhet theksuar se një përgjigje ndaj një pyetje të caktuar nuk konsiderohet të jetë interes i deputetit që parashtron pyetjet, por i qytetarëve që duan të informohen për çështje të caktuara. Kjo qasje nuk u ndjek në mënyrë të rregullt gjatë vitit 2022.

b. Mos disiplinimi i qeverisë

Me 27 korrik 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi Rregulloren e re të Kuvendit. Ndryshimet prekën edhe pikën e pyetjeve parlamentare, sa i përket mos prezencës së kabinetit qeveritar. Sipas Nenit 92, par. 8, në rastet kur ministrat nuk mund të jenë të pranishëm në seancë plenare gjatë parashtrimit të pyetjeve parlamentare, ata duhet ta njoftojnë paraprakisht Kryetarin për mungesën e tij/saj. Në rastet kur ka mungesë të kabinetit pa dërguar arsytim, atëherë Kryeministrit dhe Ministrit të caktuar i tërhiqet vërejtja publikisht nga kryesuesi i seancës për qasjen mospërfillëse ndaj Kuvendit dhe deputetit.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se Kryetari i Kuvendit nuk e ka zbatuar këtë dispozitë të Rregullores së Kuvendit, në asnjërin rast kur Kryeministri ose Ministri/ja i/e caktuar ka munguar në seancë parlamentare. Tetëdhjetë e tetë (88) pyetje parlamentare janë parashtruar në pajtim me Rregulloren e re të Kuvendit. Sipas të dhënave të mbledhura rezulton se nga 88 pyetjet e parashtruara, në 39 pyetje parlamentare ministra të caktuar të Qeverisë së Kosovës nuk ishin të pranishëm në seancën e parë plenare, kur pyetja u parashtrua nga deputeti/ja i/e Kosovës. Në asnjë prej këtyre rasteve Kryetari i Kuvendit ose Kryesuesi/ja e Kuvendit, asnjërit prej tyre nuk u'a ka tërhequr vërejtjet Kryeministrit ose ministrave të caktuar, për mungesën e tyre dhe për qasjen mospërfillëse ndaj Kuvendit dhe deputetit. Kryetari i Kuvendit njoftoi vetëm për një arsytim që i është dërguar, në rastin e mungesës e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetes Ariana Musliu-Shoshi.

[21] *Shënim:* Një pyetje parlamentare, në mungesë të parashtrimit të saj nga deputeti Adnan Rustemi dhe po ashtu edhe precizimit nga ana e Kryetarit të Kuvendit, nuk ka informacione se cilit anëtar të qeverisë i është drejtuar, si dhe një pyetje tjetër është tërhequr në seancë nga deputetja Doarsa Kica Xhelili.

Vërejtjet që duhej të jipeshin nga Kryetari ose Kryesuesi i seancës plenare:

- Shtatë (7) vërejtje për Kryeministrin e Kosovës;
- Pesë (5) vërejtje për Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Pesë (5) vërejtje për Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;
- Pesë (5) vërejtje për Ministrin e Shëndetësisë;
- Katër (4) vërejtje për Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe për Infrastrukturë,
- Tre (3) vërejtje për Ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Dy (2) vërejtje për Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Një (1) vërejtje për Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporë;
- Një (1) vërejtje për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Një (1) vërejtje për Ministrien e Drejtësisë;
- Një (1) vërejtje për Zëvendëskryeministrin e tretë për Çështje të Pakicave dhe të Drejtat e Njeriut;
- Një (1) vërejtje për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve.

c. Interpelancat

Interpelanca është një instrument i kontrollit parlamentar përmes së cilit, një grup parlamentar ose një bashkësi e deputetëve prej më së paku gjashtë deputetëve, ftojnë Kryeministrin ose ministër të caktuar për të kërkuar informacione dhe thirrjen në përgjegjësi për një çështje tejet të rëndësishme. Sipas Rregullores së Kuvendit, në praktikë, një debat i këtij lloji zhvillohet deri në tre orë, që i bie se çdo deputet i Kuvendit të Kosovës i ka 1.5 minuta për të shprehur qëndrimin e tij. Praktika parlamentare ka treguar se grupet parlamentare caktojnë deputetë që merren me temat në mënyrë që fjala e tyre të jetë me e gjatë dhe përmbajtësore.

Gjatë vitit 2022 u zhvilluan tre interpelanca, të cilat u parashtruan nga grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Në nëntor 2022, Kryeministri u ftua në interpelancë lidhur me sigurinë juridike të grave në rastet e dhunës në familje dhe përgjegjësinë e organeve shtetërore në parandalimin dhe luftimin e krimeve ndaj grave dhe vajzave. Kjo interpelancë nuk u zhvillua asnjëherë.

d. Debatet parlamentare

Kuvendi i Kosovës, aktivitetin e vet e zhvilloi edhe përmes debateve parlamentare. Gjatë vitit 2022, Kuvendi zhvilloi 15 debate parlamentare:

Grupi/et inicues/e	Tema	Vendimi i Kuvendit për mocionin e propozuar
AAK	Ngritja enorme e çmimeve të emergjës dhe konsumit.	Mocioni nuk është miratuar.
PDK/LDK/AAK	Shtrenjtimi i energjisë elektrike.	Në mungesë të pjesëmarrjes në votim, propozuesi e ka tërheqë rezolutën.
PDK/LDK/AAK	Për gjendjen e pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës.	Mocioni nuk është miratuar.
PDK/LDK/AAK	Vendimi i ZRRE-së për rritjen e çmimit të energjisë elektrike.	Mocioni nuk është miratuar.

AAK	Zhvillimet në dialogun Kosovë - Serbi.	Mocioni nuk është miratuar.
KOM PËR IE.	Lidhur me Raportin e Vendi për vitin 2021.	Nuk është propozuar mocion
PD/LDK/AAK	Lidhur me rritjen e çmimeve.	Mocioni nuk është miratuar.
LV	Lidhur me pabarazinë gjinore të grave në shoqëri.	Mocioni është miratuar.
PDK	Për politikën e jashtme.	Nuk është propozuar mocion.
AAK	Në lidhje me situatën e sigurisë në vend.	Mocioni nuk është miratuar.
LDK	Për masat që duhet të ndërmerren për të ndihmuar qytetarët të përballen me rritjen e çmimeve në produktet esenciale.	Mocioni nuk është miratuar.
AAK	Në lidhje me mosliberalizimin e vizave nga BE-ja për Kosovën.	Mocioni është miratuar.
LV	Në lidhje me adresimin e rritjes së çmimeve.	Mocioni është miratuar.
PDK	Për grevën përgjithshme të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK).	Mocioni është miratuar.
LDK	Kundër sulmeve ndaj integritetit seksual.	Mocioni është miratuar.

Tabela nr. 4 - Numri i debateve në bazë të grupeve parlamentare.

Kuvendi i ka miratuar dy mocionet e propozuara nga Lëvizja VETËVENDOSJE! dhe një nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ky i fundit i harmonizuar me grupet e tjera parlamentare. Dhjetë (10) mocionet e tjera të propozuara nga grupet parlamentare opozitare janë refuzuar nga ana e Kuvendit, si pasojë e votimit kundër ose abstenues të GP që përbën shumicën parlamentare. Në dy dy debate të tjera nuk është propozuar asnjë mocion përmbajtësor dhe në një debat parlamentar është tërhequr mocioni për arsye të kalimit të aktualitetit të çështjes dhe tentimit për tre herë të votimit të këtij mocioni.

e. Komisionet Hetimore

Nga të dhënat e monitorimit gjatë vitit 2022, rezulton se Kuvendi themeloi dy Komisione Hetimore Parlamentare, të dy këto për çështje që lidhen me sektorin energjetik në Kosovë. Iniciativa për themelimin e këtyre dy komisioneve hetimore gjatë vitit 2022 ka prodhuar përplasje të mëdha ndërmjet pozitës dhe opozitës. Kryesisht për arsye procedurale.

Së pari, komisioni i parë i propozuar nga ana e opozitës përmes 1/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, e obligon Kuvendin që detyrimisht ta formojë atë komision në seancë plenare.[22] Me këtë rast, grupet parlamentare janë të obliguara të dërgojnë propozimet e tyre në mënyrë që puna e komisionit të fillojë. Kështu, Kuvendi nuk mundet ta shmang detyrimin kushtetues dhe ligjor për themelimin e komisionit hetimor.

[22] "Neni 77, paragrafi 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, Gazeta Zyrtare e Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>). (Qasur për herë të fundit me 12 janar 2023). ; "Neni 4, paragrafi 3, Ligji Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar", 2010, Gazeta Zyrtare e Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2683>). (Qasur për herë të fundit me 12 janar 2023).

Në rastin konkret, për komisionin e parë, të propozuar nga Kryetari i Grupit Parlamentar i PDK-së, sipas asaj që është thënë nga propozuesi në seancë plenare, kemi të bëjmë me grup parlamentar nismëtar për themelimin e KHP, dhe deputetë e grupe të tjera parlamentare që i janë bashkëngjitur propozimit. Propozuesi, siç shihet në listat e nënshkrimeve është nismëtar dhe grupet e tjera janë mbështetëse të themelimit të komisionit parlamentar. Për votimin e këtij komisioni parlamentar, në disa raste, nuk pati kuorum.

Me 5 maj 2022, pas konsultimeve me kryetarët e grupeve parlamentare, Kryetari i Kuvendit deklaroi se “pas një konsultimi në Kryesinë e Kuvendit, po edhe me kryetarët e grupeve dhe me nënkryetarët, u arrit një formë e kompromisit që të vazhdojmë përpara. Pra, që të procedojmë me një mocion, të cilin do ta ngre unë si kryetar i Kuvendit, edhe në emër të grupeve parlamentare, një mocion i cili faktikisht ka qenë kërkesë e Partisë Demokratike dhe një mocion tjetër i cili ka qenë kërkesë e Lëvizjes Vetëvendosje.” Pas konsultimeve, Seanca vendosi që të themelojë dy komisionet.

Sipas Kushtetutës dhe Ligjit, dispozitat ligjore në lidhje me detyrimin e Kuvendit për komisionet hetimore janë të qarta dhe të sakta. Në këtë situatë, si nga Kryetari i Kuvendit ashtu edhe nga cdo deputet kërkohet zbatimi, dhe jo interpretimi i tij.

Tutje, Ligji Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar [neni 10] ka përcaktuar qartë rregullat që kanë të bëjnë me kryesuesin e komisioneve hetimore. Kësisoj, në një seancë të gjatë Kuvendi diskutoi në mënyrë të paarsyeshme se kush duhet të udhëheqë dhe kush duhet të jetë zv. Kryesuesi i komisionit hetimor.

Më tutje, sa i përket çështjes së ngritur, komisioni nuk do të mund ta kryente punën e vet në mënyrë cilësore dhe me efektivitet nëse tema e cila është objekt trajtimi nga një komision hetimor nuk është e precizuar, pra e qartë dhe e saktë. Komisionet hetimore duhet të jenë të përqendruara në një fushë të hetimit dhe për një periudhë të caktuar. Kuvendi mund të bëjë më shumë komisione, por jo të zgjerohet fushëveprimi dhe periudha e komisionit të propozuar. Ligji përcakton detyrimin e Kuvendit, që komisionin ta themelojë, dhe nuk le mundësi që të modifikojë propozimin.

Përtej kësaj situatë, IKD e ka parasysh se ligji aktual për hetim parlamentar ka defekte të tjera, për të cilat Kuvendi i Kosovës duhet të nis diskutimin publik për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit ose miratimin e një ligji të ri.

20. Annex 1: Aktiviteti total i deputetëve

Nga monitorimi i të gjitha fjalimeve të deputetëve të Kuvendit, rezulton se gjatë vitit 2022, deputetët e Kuvendit kanë mbajtur gjithsej 2005 fjalime.

Në vijim janë paraqitur çështjet të cilat kanë qenë objekt i trajtimit nga deputetët.

Tema/Çështja	Numri i deklaratave	%	Tema/Çështja	Numri i deklaratave	%
Ekonomi dhe Financa	309	15.4%	Çështje dhe qeverisje komunale	46	2.3%
Drejtësi	220	11%	Bujqësi	31	1.5%
Mirëqenie Sociale	195	9.7%	Kulturë dhe Sport	27	1.3%
Energji	169	8.4%	Mjedis	26	1.3%
Shëndetësi	155	7.7%	Cështje gjinore	23	1.1%
Siguri	130	6.5%	Zgjedhja e organeve kolegjiale	13	0.6%
Arsim	128	6.4%	Efikasitet në Qeverisje	10	0.5%
Administratë Publike	126	6.3%	Të drejtat e komuniteteve	9	0.4%
Dialogu Kosovë-Serbi	125	6.2%	Histori	9	0.4%
Punë të Jashtme dhe Integritet Evropian	121	6%	Diasporë	7	0.3%
Për procedurë	66	3.3%	Liria e Medias	1	0.05%
Infrastrukturë	59	2.9%			


Tabela nr. 4 - Numri i deklaratave të deputetëve në bazë të 24 temave të ngritura gjatë aktivitetit në seancat plenare të Kuvendit.

Grupi me më së shumti deklarata në të gjithë aktivitetin parlamentar, është ai i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, i pasuar nga ai Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), më tutje nga ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), grupit parlamentar MULTIETNIK dhe ai i Listës Serbe.

Por, nëse krahasohet numri i fjalimeve me numrin e deputetëve të një grupi parlamentarë, atëherë del se deputetët më aktivë kanë qenë ata nga grupi parlamentar i AAK, me nga 36.2 fjalime për deputet, pasuar nga ai i PDK me nga 33.4 fjalime për deputet, ai i LDK me 23.3 fjalime për deputet, ai i LVV me 11.8 fjalime për deputet etj.



Treguesi nr. 9 - Numri total i deklaratave në bazë të grupeve parlamentare.



Treguesi nr. 10 - Numri total i deklaratave të grupeve parlamentare në bazë të përqindjes.

Në bazë të deklaratave të deputetëve, rezultojnë se njëzetë e katër (24) deputetë nuk kanë ngritur asnjë çështje nga totali i 2005 deklaratave gjatë vitit 2022. Tetëmbëdhjetë (18) prej këtyre janë deputetët e grupit parlamentar të Listës Serbe, nëntë të cilët janë nga grupi i dorëhequr me 7 nëntor 2022, dhe nëntë nga grupi i deputetëve të cilët e bënë betimin e tyre me 17 nëntor 2022, dy deputetë janë nga grupi parlamentar MULTIETNIK, një deputet i subjektit politik GI za Slobodu, Pravdu i Opstanak (GI SPO), një deputet nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, një deputet nga Partia Unike Gorane (JGP) dhe një deputet nga subjekti politik Romani Iniciativa (RI).

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
1	Besnik Tahiri	AAK	96	16	Blerta Deliu - Kodra	PDK	43
2	Bekim Haxhiu	PDK	65	17	Avdullah Hoti	LDK	42
3	Abelard Tahiri	PDK	65	18	Arben Gashi	LDK	37
4	Adnan Rustemi	LV	60	19	Hykmete Bajrami	LDK	36
5	Time Kadrijaj	AAK	59	20	Pal Lekaj	AAK	34
6	Armend Zemaj	LDK	54	21	Jeta Statovci	LV	33
7	Driton Selmanaj	LDK	52	22	Bekë Berisha	AAK	27
8	Ganimete Musliu	PDK	52	23	Haki Abazi	LV	27
9	Armend Muja	LV	51	24	Jahja Kokaj	LV	26
10	Hisen Berisha	PDK	47	25	Rashit Qalaj	PDK	26
11	Mimoza Kusari Lila	LV	46	26	Albana Bytyqi	AAK	25
12	Eliza Hoxha	PDK	44	27	Isak Shabani	PDK	24
13	Ferat Shala	PDK	44	28	Ariana Musliu - Shoshi	PDK	23
14	Hajdar Beqa	PDK	44	29	Doarsa Kica - Xhelili	LDK	23
15	Mergim Lushtaku	PDK	44	30	Valentina Bunjaku - Rexhepi	LDK	23

Tabela nr. 5 dhe 6 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për vitin 2022.

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
31	Ardian Gola	LV	22	46	Enis Kërvan	MULTIETNIK	17
32	Enver Dugolli	LV	22	47	Florete Zejnullahu	PDK	17
33	Ramush Haradinaj	AAK	22	48	Valon Ramadani	LV	15
34	Besian Mustafa	LDK	21	49	Anton Quni	LDK	14
35	Fatmire Kollçaku-Mulhaxha	LV	20	50	Artan Abrashi	LV	14
36	Fitore Pacolli - Dalipi	LV	20	51	Enver Hoxhaj	PDK	14
37	Lumir Abdixhiku	LDK	20	52	Tinka Kurti	LV	14
38	Dimal Basha	LV	19	53	Arijeta Rexhepi	LV	12
39	Elmi Reçica	PDK	19	54	Nijazi Isaku	LV	12
40	Mirlinda Tishukaj-Sadiku	LV	19	55	Visar Korenica	LV	12
41	Shemsedin Dreshaj	AAK	19	56	Besim Muzaqi	LV	11
42	Memli Krasniqi	PDK	18	57	Milazim Salijaj	LV	11
43	Rrezarta Krasniqi	LDK	18	58	Agon Batusha	LV	10
44	Arjeta Fejza	LV	17	59	Eman Rrahmani	LV	10
45	Driton Hyseni	LV	17	60	Fidan Jilta	MULTIETNIK	10

Tabela nr. 7 dhe 8 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për vitin 2022.

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
61	Vlora Dumoshi	LDK	10	76	Arbër Rexhaj	LV	6
62	Agim Veliu	LDK	9	77	Arta Bajralia	LV	6
63	Enver Haliti	LDK	9	78	Fatmir Humolli	LV	6
64	Erxhan Galushi	MULTIETNIK	9	79	Haxhi Avdyli	LV	6
65	Fjolla Ujkani	LV	9	80	Labinotë Demi - Murtezi	LV	6
66	Mirsad Shkreta	LV	9	81	Marigona Geci	LDK	6
67	Shqipe Mehmeti-Selimi	LV	9	82	Vendenis Lahu	LV	6
68	Xhavit Haliti	PDK	9	83	Alban Bajrami	LV	5
69	Albena Reshitaj	AAK	8	84	Ardian Kastrati	PDK	5
70	Jetmire Vrenezi	LV	8	85	Avni Dehari	LV	5
71	Arbëresha Kryeziu-Hyseni	LV	7	86	Duda Balje	MULTIETNIK	5
72	Burim Meta	LV	7	87	Fitim Haziri	LV	4
73	Fridon Lala	MULTIETNIK	7	88	Fitim Uka	LV	4
74	Hydajet Hyseni - Kaloshi	LV	7	89	Gani Krasniqi	LV	4
75	Kujtim Shala	LDK	7	90	Gazmend Gjyshinca	LV	4

Tabela nr. 9 dhe 10 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për vitin 2022.

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
91	Glauk Konjufca	LV	4	106	Behgjet Pacolli	LDK	1
92	Gramos Agusholli	LV	4	107	Adem Hodza	PG	0
93	Halil Thaçi	LV	4	108	Bekim Arifi	MULTIETNIK	0
94	Luan Aliu	LV	4	109	Biljana Maksic	PG	0
95	Igor Simic	LS	4	110	Cvetko Veljkovic	PG	0
96	Adelina Grainca	LV	3	111	Drita Millaku	LV	0
97	Adriana Matoshi	LV	3	112	Fadil Gashi	PG	0
98	Bahrim Sabani	ULTIETNIK	3	113	Ksenija Bozovic	PG	0
99	Shqipe Isufi	LV	3	114	Milan Joksimovic	PG	0
100	Ylleza Hoti	LV	3	115	Milan Kostic	PG	0
101	Ekrem Mustafa	LV	2	116	Nenad Radenkovic	PG	0
102	Mefail Bajqinovci	LV	2	117	Oliver Zdravkovic	PG	0
103	Nasuf Bejta	LV	2	118	Rados Mihajlovic	PG	0
104	Salih Zyba	LV	2	119	Samra Ilijaz	MULTIETNIK	0
105	Saranda Bogujevci	LV	2	120	Svetislav Jokic	PG	0

Tabela nr. 11 dhe 12 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për vitin 2022.

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
121	Zoran Maksimovic	PG	0
122	Slavko Simic	LS	0
123	Miljana Nikolic	LS	0
124	Zoran Mojsilovic	LS	0
125	Verica Ceranic	LS	0
126	Branislav Ceranic	LS	0
127	Milos Perovic	LS	0
128	Ljubinko Karadzic	LS	0
129	Jasmina Dedic	LS	0
130	Dragana Antonijevic	LS	0

Tabela nr. 13 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për vitin 2022.

21. Annex 2: Kuvendi në numra

Më 22 mars 2021, u konstitua Kuvendi i Kosovës pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në shkurt të po këtij viti. Në po të njejtën seancë, Kuvendi zgjodhi për Kryetar të Kuvendit, Glauk Konjufca, nga partia më e madhe parlamentare si dhe u zgjodh Qeveria e Kosovës, në krye të së cilës ishte votuar, Albin Kurti.

Përgjatë kësaj legjislature, ende në vazhdim, ishte një deputete nga ana e GP të PDK-së, e cila kaloi në GP të LV-së, dhe një deputete nga LV që kaloi në GP të LDK-së.


Bazuar në rezultatin dhe zgjedhor dhe ndryshimet e bëra, në fund të vitit 2022, përbërja e grupeve parlamentare të konfirmuara ishte si në vijim:

Nr.	Grupi parlamentar	Numri i deputetëve
1	Lëvizja VETËVENDOSJE!	58
2	Partia Demokratike e Kosovës	18
3	Lidhja Demokratike e Kosovës	16
4	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	8
5	Multietnik	8
6	Pa grup parlamentar	12

Tabela nr. 14 - Përbërja e grupeve parlamentare të konfirmuara deri në fund të vitit 2022

Struktura e deputetëve në bazë të gjinisë: 40 gra - 80 burra.

Udhëheqja e komisioneve parlamentare, në bazë të grupeve parlamentare



Në bazë të strukturës gjinore:

- 7 komisione të udhëhequra nga gratë deputete
- 7 komisione të udhëhequra nga burrat deputetë

Kontakt

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD
Adresa: Rruga “Ilaz Agushi”, Numër 146.
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail: info@kli-ks.org
Ueb: www.kli-ks.org